

VENDIM
Nr.835, datë 15.7.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.42, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT,
KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË
VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “b” të pikës 1 të kreut III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet” të rregullores, që i bashkëlidhet vendimit nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha